



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**R A P O R T I M
I PROKURORES SË PËRGJITHSHME TË REPUBLIKËS**

**MBI
GJENDJEN E KRIMINALITETIT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2007**

**PËRPARA:
K U V E N D I T**

**E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit!
Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë!**

Në përmbushje të detyrimit kushtetues, me kërkesën Tuaj, jam para Jush për të informuar, me realizëm dhe ndjenjë përgjegjësie, për gjendjen e kriminalitetit në vitin 2007, drejtimet kryesore, shkaqet dhe përparësitë në luftën kundër tij, për punën e Prokurorisë si organ përgjegjës në realizimin me sukses të ndjekjes penale, si dhe për të evidentuar disa drejtime dhe përparësi që kërkojnë zgjidhje dhe mbështetjen Tuaj, me synim rritjen më tej të efikasitetit në luftën kundër kriminalitetit.

Nisur nga analiza e treguesvë të veprimtarisë në të gjithë nivelet e prokurorisë, mund të themi se viti 2007 evidenton progres në rritje të organit të akuzës në ushtrimin e përgjegjësiwe kushtetuese e ligjore. Falë angazhimit të prokurorëve në drejtimet më kryesore të ushtrimit të funksioneve dhe detyrave të tyre, në veprimtarinë e organit që drejtoj vihet re rritje e treguesve të volumit të punës, efektivitetit dhe ligjshmërisë në ndjekjen penale, ngritjen e akuzës në gjykatë në emër të shtetit, ekzekutimin e vendimeve penale dhe mbikëqyrjen e vuajtjes së dënimit, si dhe në ushtrimin e funksioneve të tjera të ngarkuara me ligj.

Progres evidentohet krahasuar me vitet paraardhese, gjithashtu, në rritjen e efektivitetit të ndjekjes penale kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe veprave penale të lidhura me të. Pavaresisht nga te dhenat qe do te prezantohen, jemi të vetdishëm se duhet të merren masa të tjera të

domosdoshme, për të garantuar rritjen e suksesit në luftën kundër krimit, duke kërkuar mbështetje në komunikimin me Ju dhe me strukturat e tjera të shtetit. Kjo detyrë është aktuale, për të përmbushur angazhimet që ka Shqipëria në kuadrin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim – Asocimit me Bashkimin European, sepse lufta ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit mbeten prioritare, si dhe roli i prokurorisë dhe i aktorëve të tjerë të sistemit të drejtësisë penale në përmbushjen e kësaj detyre është determinant.


Mënyra më sintetike e përshkrimit të punës së Prokurorisë në ushtrimin e funksioneve të saj është gjuha e shifrave, prandaj më lejoni t’Ju paraqes të grupuara treguesit e punës, shtrirjen dhe tendencat e kriminalitetit, si më poshtë:

I. TREGUESIT KRYESORË TË PROCEDIMEVE PENALE, NË FAZËN E HETIMEVE PARAPRAKE DHE NGRITJEN E AKUZËS NË GJYKATË.

Prokuroritë e shkallës së parë, gjatë vitit 2007, në hetimet paraprake kanë **ndjekur 19.649** procedime penale, me 11.100 të pandehur, nga të cilët 3.197 persona me masë sigurimi “arrest burg”. Nga këto, janë **regjistruar 15.909** procedime penale të reja, me 8.968 të pandehur, prej të cilëve 2.607 persona me masë sigurimi “arrest burg”. **Krahasuar me vitin 2006, numri i procedimeve të regjistruara është rritur 11 për qind.**


Më poshtë, në tabelë dhe paraqitje grafike krahasuese të viteve 2006-2007, evidentohen treguesit e volumit të procedimeve penale të ndjekura, përfshi procedimet penale të mbartuara nga viti 2006, të regjistruara dhe të rifilluara në vitin 2007.

Vitet	Mbartura	Regjistruar	Rifilluara	Ndjekje Penale
2006	2836	14353	776	17965
2007	3091	15903	655	19649
Krahasimi	Rritje 9 %	Rritje 11%	Ulje 16%	Rritje 9.4%




Tendencën në **rritje** të numrit të procedimeve të regjistruara e evidenton analiza e shtrirjes së procedimeve penale, sipas Prokurorive të shkallës së parë, krahasuar me procedimet e regjistruara në vitin 2006, Kështu, rritje eidentohet në Prokuroritë e shkallës së parë: Tiranë 5 për qind, Elbasan 44 për qind, Shkodër 8 për qind, Durrës 5 për qind, Fier 35 për qind, Vlorë 32 për qind, Berat 20 për qind, Kavajë 25 për qind, Sarandë 36 për qind, Mat 29 për qind, Kukës 19 për qind, Tropojë 13 për qind dhe Lezhë 18 për qind, si në tabelën dhe paraqitjen grafike, më poshtë:

Vitet	Prokuroritë e Shkallës së Parë													
	Berat	Durresi	Elbasan	Fieri	Kavajë	Korçë	Sarandë	Shkoder	Tiranë	Tropojë	Vlora	Mati	Lezhe	Kukes
2006	393	1133	822	610	295	776	258	937	4870	158	1137	136	381	219
2007	473	1193	1181	826	370	804	351	1009	5117	178	1503	175	449	260
Ritja në %	20%	5%	44%	35%	25%	4%	36%	8%	5%	13%	32%	29%	18%	19%




Kjo analizë, gjithashtu, evidenton tendencën në **ulje** të procedimeve të regjistruara në Prokuroritë e shkallës së parë: - Dibër 7 për qind, - Krujë 8 për qind, - Kurbin 19 për qind, - Lushnje 4 për qind, - Gjirokastrë 6 për qind, të ekspozuara në tabelën dhe paraqitjen grafike, si më poshtë:



Vitet	Prokuroritë e Shkallës së Parë						
	Krimet e Renda	Dibër	Krujë	Kurbin	Lushnja	Puka	Gjirokastra
2006	101	289	257	290	332	130	581
2007	93	270	236	235	318	119	546
Ulje	8%	7%	8%	19%	4%	8%	6%



Në vitin 2007, janë **përfunduar hetimet**, për 15.757 procedime penale, me 9.546 të pandehur, që zënë 80.2 për qind të procedimeve të ndjekura ose 9 për qind procedime të përfunduara më shumë se në vitin 2006. Më poshtë, në tabelën dhe paraqitjen grafike evidentohej treguesit e procedimeve dhe të pandehurve, sipas mënyrës së përfundimit të ndjekjes penale në hetimet paraprake, krahasuar në vitet 2006-2007.

Vitet	Gjyqit		Pushuara		Pezulluara		Përfunduara	
	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur	Procedime	Pandehur
2006	6158	7529	4522	1331	3790	17	14470	8877
2007	6489	7674	4936	1861	4332	11	15757	9546
Krahasimi	Ritje 5%	Ritje 2%	Ritje 9%	Ritje 40%	Ritje 14%	Ulje 36%	Ritje 9%	Ritje 8%





Sipas mënyrës së përfundimit të hetimeve rezulton kjo gjendje:

1. Është **ngritur akuzë** në gjykatë për 6.489 procedime, me 7.674 të pandehur, prej të cilëve 2.374 persona të arrestuar në burg ose krahasuar me vitin 2006 me **rritje 5 për qind** të procedimeve dhe 2 përqind të pandehurve. Në ndjekjen penale në hetim evidentohet se **janë dërguar në gjykatë 42 për qind e procedimeve të përfunduara** ose **është ngritur akuzë në gjykatë për rreth 81 për qind të të pandehurve ndaj të cilëve janë përfunduar hetimet**.

2. Janë **pushuar** 4.936 procedime, me 1.861 të pandehur, me 91 persona me masë sigurimit “arrest në burgë”, që **zënë 31 për qind** të procedimeve të përfunduara. Krahasuar me vitin 2006 me **rritje 9 për qind** të procedimeve të pushuara, si dhe me **ulje 27 për qind** të pushimeve me persona me masë sigurimi “arrest burg” Fenomeni I vendimeve të pushimeve të çështjeve penale në kushtet kur personat e hetuar gjendeshin me masë sigurimi “arrest në burg”

pavarësisht se prezantohet me të dhëna me të mira se vitet e mëparshme, duhet konsideruar shqetëues. Për të minimizuar këto raste I është terhequr vëmendja të gjithë prokurorëve në mënyrë të vazhdueshme që të bëjnë kujdesin maksimal kur të operojnë me vendosjen e masave të sigurimit personal ndaj shtetasve vecanërisht me masën e arrestit në burg në mënyrë që vendosja e kësaj mase të mos çënojë padrejtësisht liritë e shtetasve dhe të mos shndërrohet në një mjet shantazhimi ndaj tyre dhe abuzimi të organeve të drejtësisë. E gjithë kjo vendimarrje është dhe do të jetë nën kontrollin e vazhdueshëm nga prokurorët më të lartë me qëllim shmangien e këtyre rasteve dhe zbatimin me korrektesë të ligjit. Në **rritjen e procedimeve të pushuara** në ndjekjen penale në hetimet paraprake **ka ndikuar zbatimi i ligjit “Për dhënie amnistie”**. Sipas shkaqeve ligjore mbi të cilët është vendosur pushimi i çështjeve, evidentohet se:

2.1 Janë pushuar 1.516 çështje, me 462 të pandehur, me arsyetimin ligjor se “...fakti nuk ekziston ose fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale”, neni 328/1 gërmat “a, b” të K. Pr. Penale. Procedimet e pushuara për këtë shkak ligjor zënë 30.7 % (për qind) të totalit të procedimeve të pushuara, ose krahasuar me vitin 2006 me **ulje 12 për qind**.

2.2 Janë pushuar 697 çështje, me 529 të pandehur me arsyetimin ligjor: “del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale ose nuk provohet që e ka kryer ai”, neni 328/1 gërma “dh” e K. Pr. Penale. Procedimet e pushuara për munges provash zënë rreth **14 për qind** të totalit të çështjeve të pushuara.

2.3 Janë pushuar 2724 çështje, me 879 të pandehur, për shkaqe të tjera ligjore, ose krahasuar me vitin 2006 me rritje 20 për qind. Në këtë rritje, veç pushimeve në zbatim të ligjit “Për dhënie amnistie” një përqindje të konsiderueshme e zënë: - pushimet e çështjeve për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale të procedimeve të pezulluara për kundravatje penale, si dhe - pushimet e çështjeve të filluara mbi ankimin e të dëmtuarve, të cilët kanë hequr dorë nga ankimi gjatë hetimeve paraprake, neni 328/1 gërma “c” e K. Pr. Penale.

3. Pezullimi i hetimeve është vendosur për 4.332 çështje, që zënë 27 për qind e procedimeve të përfunduara, ose krahasuar me vitin 2006 me rritje 14 për qind. Të ndarë sipas shkaqeve ligjore për të cilët është vendosur pezullimi, gjendja paraqitet:

3.1 Për shkak se autori i veprës nuk njihet janë pezulluar hetimet dhe vazhdon gjurmimi nga policia për zbulimin e autorëve për 4.330 procedime penale, që zënë rreth 99.95 për qind të procedimeve penale të pezulluara. Si rezultat i punës së përbashkët të prokurorisë me strukturat e policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit, janë rifilluar hetimet për 655 procedimeve për krime të pazbuluara dhe janë vënë nën akuzë 237 të pandehur, prej të cilëve 77 persona me masë sigurimi “arrest në burg”, që përfaqësojnë krimet e ndodhura vite më parë dhe/ose në vitin 2006 me çështje të pezulluara;

3.2 Ndërsa, për shkak se të pandehurit kanë vuajtur nga një sëmundje e rëndë janë pezulluar 2 procedime penale.

4. Është vendosur **mosfillimi** i procedimit për **4075 kallëzime apo referime** të veprës penale në prokurori, për “*Rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit*”, nenet 290 e 291 të K. Pr. Penal, ose krahasuar me vitin 2006, me **rritje 19 për qind**. Në rritjen e procedimeve të mosfilluara ka ndikuar, gjithashtu, **zbatimi i ligjit “Për dhënie amnistie”**.

5. Me **zgjatje afati** janë ndjekur **1.135 procedime**, që **zënë rreth 6 për qind** të procedimeve në ndjekje ose **me ulje 26 për qind** krahasuar me vitin 2006.


6. Janë **mbartur** për vitin 2008 në fazën e hetimeve paraprake **3.576 procedimeve**, me 1450 të pandehur, prej të cilëve 666 persona me masë sigurimi “arrest në burg”, ose **rreth 18 për qind** e numrit të përgjithshëm të procedimeve të ndjekura.

II. TREGUESIT KRYESORË TË PËRFAQËSIMIT TË AKUZËS DHE TË POLITIKËS SË PROCEDIMIT PENAL NË GJYKIM.

Të nderuar deputetë,


1. Gjatë vitit 2007, prokurorët e shkallës së parë **kanë përfaqësuar akuzën në gjykimet** penale të **5.613 çështjeve**, në ngarkim të 6.922 të pandehurve, prej të cilëve 2.028 persona me masë sigurimi “arrest në burg”. Krahasuar me vitin 2006 me **ulje 3 për qind** të procedimeve dhe **1 për qind të pandehurve** ndaj të cilëve është përfaqësuar akuza në gjykatë, si në tabelën dhe paraqitjen grafike krahasuese 2006-2007, si më poshtë.

Vitet	Gjykuar		
	Procedime	Pandehur	Arrestuar
2006	5791	7009	2144
2007	5613	6922	2028
Krahasimi	Ulje 3 %	Ulje 1 %	Ulje 5 %




Analiza e treguesve sipas llojeve të gjykimit, të ekspozuara në tabelën dhe paraqitjen grafike si më poshtë, evidenton se:

- për 62 për qind të çështjeve të gjykuara është aplikuar gjykimi i shkurtuar ose me ulje 5 për qind, krahasuar me vitin 2006;
- për 36 për qind të çështjeve të gjykuara është aplikuar gjykimi i zakonshëm, si dhe;
- për 2 për qind të çështjeve të gjykuara është aplikuar gjykimi i drejtpërdrejtë ose krahasuar me vitin 2006 me rritje 16 për qind.




Vitet	Llojet e Gjykimeve		
	Drejtperdrejte	Zakonshem	Shkurtuar
2006	114	2153	3555
2007	132	2063	3496
Krahasimi	Ritje 16 %	Ulje 4 %	Ulje 2 %




Në gjykimin e këtyre çështjeve, prokurorët e shkallës së parë kanë kërkuar krahas deklarimit fajtor, dënimin e të pandehurve me lloje dënimi si: **1.961 persona me gjobë dhe 3.913 persona me burgim**. Kërkesat për dënimin me burgim, zënë 56.5 për qind të kërkesave të prokurorëve dhe sipas llojeve janë: - 5 me burgim të përjetshëm, - 30 me paraburgim, - 9 me ulje të dënimit nën kufijtë e parashikuar me ligj, - 1.026 me dënim minimal, - 1.904 me dënim mesatar, - 271 me dënim maksimal, - 912 me pezullim të ekzekutimit të dënimit me burgim. Gjithashtu, prokurorët kanë kërkuar tërheqjen e akteve për 54 procedime, pushimin e akuzës për 17 të pandehur, pushimin e çështjes në gjykim për 787 të pandehur - mbështetur dhe në ligjin për dhënie amnistie -, si dhe pafajësi për 5 të pandehur.

Gjykatat e shkallës së parë, mbi këto kërkesa, kanë vendosur deklarimin fajtor dhe dënimin e të pandehurve me lloje dhe masa dënimi më të ulta se kërkesat e prokurorëve, plus minus, sipas tabelës dhe paraqitjes grafike, si më poshtë, lidhur me kërkesat e prokurorëve dhe vendimet e gjykatës për llojet dhe masat e dënimit të krahasuara në vitet 2006-2007. **Pushimet e çështjeve dhe akuzave të vendosura nga gjykata zënë 12.4 për qind të të pandehurve të gjykuar, ndërsa, pafajësit të cilat kanë tendencë në ulje zënë 2.5 për qind të të pandehurve të gjykuar.**

	2006		2007		Krahasimi	
	Kërkesa Prokurorit	Vendime Gjykatës	Kërkesa Prokurorit	Vendime Gjykatës	Kërkesa Prokurorit	Vendime Gjykatës
Lloji Kërkesës ose Vendimit						
Gjobe	2570	2414	1961	1921	Ulje 34%	Ulje 0.80%
Burgim	4438	4381	4159	3913	Ulje 6%	Ulje 0.89%
T/K.Akteve	54	42	54	51	1.00%	Rritje 21%
P/Akuze	23	9	17	22	Ulje 26%	Rritje 244%
P/Çështje	146	213	787	840	Rritje 539%	Rritje 394%
Pafajesi	9	177	5	175	Ulje 44%	Ulje 1%




	2006		2007		Krahasimi	
Lloje Dënimi me Burgim	Kërkesa Prokurorit	Vendime Gjykatës	Kërkesa Prokurorit	Vendime Gjykatës	Kërkesa Prokurorit	Vendime Gjykatës
Paraburg	47	58	30	33	Ulje 36%	Ulje 43%
Minimum	1196	1279	1026	1017	Ulje 24%	Ulje 20%
Mesatar	1942	1698	1904	1705	Ulje 2%	1.00
Maksim	298	241	271	211	Ulje 9%	Ulje 12%
B/Perjet	16	13	7	5	Ulje 66%	Ulje 62%
N/Minim.	10	16	9	41	Ulje 10%	Rritje 256%
Pez/Ekz.	928	1048	912	904	Ulje 2%	Ulje 14%





2. Prokurorët e apelit, për gjykimet e themelit kanë përfaqësuar akuzën në **2.323 çështje** dhe për masat e sigurimit në **1.016 çështje**. Treguesit e volumit të punës, sipas prokurorive të apelit për përfaqësimin e akuzës në gjykimet e themelit dhe për shqyrtimin e masave të sigurimit, të krahasuar në vitet 2006-2007, evidentohen në tabelën dhe paraqitjen grafike, si më poshtë:

	Themeli		M.Sigurimi		Krahasimi	
	2006	2007	2006	2007	Themeli	M.Sigurimi
Apeli Tirane	949	973	362	385	Rritje 3%	Rritje 6%
Apeli Durres	319	380	108	147	Rritje 19%	Rritje 36%
Apeli Shkoder	355	255	71	79	Ulje 38%	Rritje 11%
Apeli Gjiroka	155	150	59	34	Ulje 3%	Ulje 42%
Apeli Vlore	525	325	116	178	Ulje 48%	Rritje 53%
Apeli Korçe	134	145	91	58	Rritje 8%	Ulje 36%
Apeli K.Renda	63	59	136	133	Ulje 6%	Ulje 2%
Ap.Usharak	125	36	2	2	Ulje 71%	Njejt
Gjithsejt	2625	2323	945	1016	Ulje 12%	Rritje 8%



Treguesit e lartpërmendur të krahasuar në vitet 2006 – 2007, evidentojnë ulje të numrit të çështjeve të themelit të shqyrtuara në apel në masën **12 për qind**, si dhe **rritje** të rasteve të shqyrtimit për masat e sigurimit personal në apel në masën **8 për qind**.

3. Prokurorët e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm kanë **përfaqësuar 185 çështje** të rekursuara dhe të shqyrtuara në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese. Krahasuar me vitin 2006, **rreth 20 për qind** çështje më pak. Sipas llojit të gjykimeve janë 167 çështje themeli, 18 çështje për masa të sigurimit personal, 4 raste në Gjykatën Kushtetuese. Kërkesat e prokurorëve të kësaj Zyre në **rreth 53.2 për qind të çështjeve janë pranuar** nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Këto tregues për vitin 2007 dhe të krahasur me vitin 2006 evidentohe në paraqitjen grafike, si më poshtë.



Megjithëse, numri i çështjeve të ankimuar, krahasuar me vitin 2006, ka pasur një rënie të lehtë, ai vazhdon të mbetet relativisht i lartë. Kjo lidhet me faktin se në shumë çështje penale janë evidentuar gabime të shkallëve më të ulta të gjyimit për shkak të mangësive profesionale dhe interesa jashtëligjore. Në këtë kontekst apelimi është konsideruar si mundësi për më tepër drejtësi.

4. Rritja e efektivitetit të ndjekjes penale dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të individit nga prokurorët në ushtrimin e funksioneve të tyre mbeten ndër synimet tona kryesore. Në analizën e këtyre treguesve gjatë analizave vjetore, krahas arritjeve në rritjen e efektivitetit të ndjekjes penale, është tërhequr vëmendja dhe jemi fokusuar në përmirësimin e punës së prokurorëve në ushtrimin e funksioneve, si më poshtë:

Së pari, për t'u mundësuar prokurorëve që në hapat e para të hetimeve paraprake, t'i trajtojnë çështjet në një mënyrë të diferencuar. Ata janë udhëzuar që të përdorin më gjërësisht teknikat e veçanta të hetimit në kërkimin dhe administrimin e provave, siç janë përgjimet, vëzhgimet, veprimet e simuluar, agjentin e infiltruar, ADN-në dhe ekzaminime të tjera shkencore të provave objektive, veçanërisht në luftën kundër krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme, korrupsionit dhe krimeve të tjera të rënda.

Së dyti, për të zgjedhur dhe kërkuar në gjykatë masa më të përshtatshme të sigurimit personal, duke pasur si synim që masa e sigurimit “arrest në burg” të aplikohet vetëm për krime të rënda dhe kur çdo masë tjetër alternative është e papërshtatshme, për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit. Megjithë angazhimet dhe përpjekjet e bëra për respektimi e të drejtave dhe të lirive themelore të subjekteve të procedimit penal, në inspektimet dhe kontrollet e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm në disa prokurori janë konstatuar shkelje të këtyre të drejtave, si p.sh.: mosrespektim apo moszbatim i përpiktë i kriterëve dhe procedurës për kontrollin e banesave, mosrespektim i detyrimit ligjor të prokurorit për fillimin e ndjekjes penale mbi bazën e kallëzimeve penale të paraqitura nga shtetasit, marrje të vendimeve për pushim apo mosfillim të procedimit pa pasur bazën e duhur ligjore dhe pa kryer veprimet e nevojshme hetimore, si dhe neglizhencia në zbatimin e kërkesave të K. Pr. Penale në lidhje me njoftimin e vendimit për pushimin e çështjes apo mosfillimin e procedimit.

Së treti, janë bërë përpjekje për të forcuar më tej kujdesin në ngritjen e akuzës dhe përfaqësimin e saj në gjykatë, me synim për të shmangur çdo procedim në kundërshtim me ligjin apo kërkesë për dënim të pa drejtë, gjë që ka çuar në uljen e rasteve kur gjykatat kanë kthyer aktet, ose kanë vendosur pafajësi, pushime çështje apo akuze.

Së katërti, për të shmangur ashpërsimin e panevojshëm të kërkesave për lloje e masa dënimi, duke ia nënshtruar rivlerësimit kritik të gjendjes aktuale të dhënies së dënimit me burgim, duke përshtatur më mirë kërkesat për dënime në përputhje me një politikë penale sa më të drejtë, më synim për aplikimin e alternativave të dënimit me burgim për kundravajtje penale dhe vepra penale me rrezikshmëri të vogël.

Së pesti, është orientuar unifikimi i përgjithshëm në dhënien e dënimit, veçanërisht për vepra penale të kryera më shpesh në rrethet gjyqësore dhe në shkallë vendi, me synim për të shmangur rastet që kërkesat e prokurorit për caktim lloji e mase dënimi të ndryshëm ndaj personave që kanë kryer të njëjtën vepër penale dhe në të njëjtat rrethana, për të shmangur shkeljen e barazisë para ligjit.

Njejtësimi në dhënien e dënimit i shërben rritjes së efektivitetit dhe racionalizimit të procesit të punës së prokurorëve dhe për këtë qëllim do të ishte e domosdoshme të organizoheshin trainime, seminare dhe konferenca mbi dhënien e dënimit në nivel rrethi gjyqësor, apeli dhe në shkallë vendi, si dhe informimi i vendimarrësve me statistikën dhe analizat krahasuese në lidhje me nivelet e ndryshme të dhënies së dënimit për vepra penale relativisht të njëjta.


Pajisja dhe lidhja e të gjithë prokurorive të vendit me rrjetin e sistemit elektronik të manaxhimit të rasteve, shpresojmë dhe besojmë se do të kontribuojnë pozitivisht për mënjanimin e praktikave të gabuara apo në shkelje të ligjit.


III. TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË FORMËS SË PRERË DHE TË MBIKËQYRJES SË VUAJTJES SË DËNIMIT.

Të nderuar deputetë,

1. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë është një nga drejtimet kryesore të punës së Prokurorisë. Në vitin 2007, prokurorët e shkallës së parë kanë urdhëruar ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë, për **5.405 të dënuar** ose krahasuar me vitin 2006 me **ulje 36 për qind**, prej të cilëve 9 dënime me burgim të përjetshëm, 2.747 dënime me burgim dhe 2.335 dënime me gjobë. Nga këto janë ekzekutuar nga policia gjyqësore dhe përmbarimi 3.089 vendime penale, ose **me ulje 7 për qind** krahasuar me vitin 2006, të evidentuara në tabelat dhe paraqitjen grafike, si më poshtë.

Llojet e Denimit	Urdheruar Ekzekutimi	Ekzekutuar	Ngelen për tu Ekzekutuar
Burgim Perjetshëm	9	7	25
Burg	2747	1903	1539
Gjobë	2335	961	1792
Dënim Plotsues	314	218	125
Gjithsejt, 2007	5405	3089	3481





Së bashku me vendimet e mbartura nga vitet e kaluara, **ngelen për tu ekzekutuar 3.481** vendime gjyqësore penale të formës së prerë, nga të cilat **1.539 me burgim, ku 25 janë me burgim të përjetshëm dhe 1.792 dënime me gjobë**. Krahësuar me vitin 2006 dënimet e mbartura të paekzekutuara kanë **ulje në masën 29.7** për qind, çka vlerësojmë se është për tu përshendetur puna e mirë e Policisë së Shtetit për vënien në ekzekutim të vendimeve penale të formës së prerë në ngarkim të të dënuarve për krime të rënda të paekzekutuara.

Siç del nga të dhënat statistikore për vitin 2007 në krahasim me vitin 2006, ekzekutimi i dënimeve me burgim ka një rritje në masën 6% dhe ekzekutimi i dënimeve me gjobë paraqet një rritje në masën 12%.

Prokurorët në shkallë vendi i kanë kushtuar vëmendje të veçantë problemit të ekzekutimit të vendimeve penale gjyqësore të formës së prerë, duke zbatuar kërkesat e dispozitave të K.Pr.Penale si dhe dispozitat e ligjit nr. 8331, dt. 21.04.1998 **“Për ekzekutimin e vendimeve penale”**. Në të gjitha rastet Prokurorët kanë nxjerrë urdhërat e ekzekutimit, pasi i janë vënë në dispozicion vendimet penale të formës së prerë nga ana e gjykatave, ose janë tërhequr kryesisht. Nga ana e Prokurorëve urdhërat e ekzekutimit janë nxjerrë brenda afateve ligjore dhe u janë dërguar për zbatim organeve të Policisë për masat e sigurimit dhe dënimet me burgim dhe përmbarimit për dënimet me gjobë.

Për rritjen e efektivitetit të punës lidhur me ekzekutimin e vendimeve, është forcuar bashkëpunimi me organet e Policisë, veçanërisht për personat në kërkim, ku në çdo muaj analizohet ky problem duke rakorduar dhe pasqyruar në vazhdimësi ndryshimet e listës së personave në kërkim. Me gjithë përmirësimet e bëra, përsëri vazhdon të ketë një numër të konsiderueshëm të urdhërave të ekzekutimit për dënime me burgim që nuk janë ekzekutuar. Kjo gjendje vjen për faktin se shumë të pandehur i shmangen hetimit dhe gjykimit të çështjeve. Në këtë drejtim ka vend që puna e Policisë të forcohet me synim identifikimin dhe kapjen e personave në kërkim që fshihen brenda territorit të Shqipërisë dhe vënien në lëvizje të kërkimit ndërkombëtar nëpërmjet Interpolit për personat që largohen jashtë vendit. Ndërsa ekzekutimi i pakët i dënimeve me gjobë është vërtetuar për faktin se në shumicën e rasteve të dënuarit nuk kanë pasuri

dhe të ardhura për të shlyer dënimin, ku në shumë raste është bërë konvertimi i dënimit nga gjobë në burg.

Duhet theksuar se jo gjithmonë respektohen afatet e përcaktuara në dispozitat ligjore nga ana e gjykatave për dërgimin e vendimeve të formës së prerë në Prokurori për t'u vënë në ekzekutim. Veçanërisht më të theksuara janë zvarritjet në dërgimin e vendimeve të formës së prerë në gjykatat e rretheve nga ana e gjykatave të Apelit dhe Gjykata e Lartë. Një gjendje e tillë ka ardhur për faktin se nuk ekziston rregullim ligjor, ku të përcaktojë afate për dërgimin e vendimeve të formës së prerë në gjykatat e rretheve, të cilat ia dërgojnë Prokurorit për vënien në ekzekutim.

Për këtë, më dt. 28.04.2008 i është kërkuar Ministrit të Drejtësisë për të inicjuar një shtesë për këtë qëllim në ligjin nr. 8331 dt.21.04.1998 ***“Për ekzekutim e vendimeve penale”***.

2. Mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në veçanti për vënien në ekzekutim të dënimeve me burgim, si dhe respektimi i të drejtave të të dënuarve gjatë vuajtjes së dënimit me burgim, mbetet një ndër drejtimitet e punës së prokurorisë, me synim riedukimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve në shoqëri.

Tërheq vemendjen numri i lartë i të dënuarve në vitet e fundit. Gjendja aktuale në institucionet e riedukimit lidhur me të paraburgosurit dhe të dënuarit me burgim, evidenton situatën e mbipopullimit, për shkak të mungesës së kapacitetit mbajtës të tyre. Përmirësimi i kushteve të burgimit dhe të paraburgimit dhe i kapaciteteve të tyre mbetet detyrë për të gjitha hallkat dhe aktorët e sistemit të drejtësisë penale.

Shifrat e larta të të dënuarve, veçanërisht ato me burgim, gjithashtu, tërheqin vemendjen për të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë penale për të rivlerësuar dhe ndërmarrë hapat e duhura për përmirësimin e kuadrit ligjor, institucional dhe forcimin e kapaciteteve të tyre, me synim që në një të ardhme afat shkurtër të aplikohen më gjërësisht dënimet alternative të dënimit me burgim, për faktin se burgimi dhe paraburgimi kanë kosto të lartë financiare dhe shoqërore, si dhe duke u nisur nga parimi se kriminalitetin në shoqëri nuk e ul vetëm vënia e kriminelëve pas hekurave.


Në këtë drejtim sugjerojmë se duhet punuar për arritjen e një politike dënimi, e cila duke marrë parasysh gjendjen e kriminalitetit në vend, si dhe specifikat psikologjiko-sociale të shoqërisë shqiptare, të ketë në dorë një katalog masash shtërnguese të mbështetura në parimin që përmes dënimeve gjyqësore të goditet krimi dhe jo shoqëria.

VI. TREGUESIT KRYESORE MBI LLOJET, FORMAT, INTENSITETIN, GJENDJEN DHE SHTRIRJEN E VEPRAVE PENALE.

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Në vitin 2007, gjendja e kriminalitetit, sipas procedimeve penale të regjistruara, e krahasuar me vitin 2006, **evidenton tendencën në rritje të procedimeve të regjistruara në masën 11 për qind.** Klasifikimi, sipas grup veprat penale evidenton, tre drejtimet më kryesore të përhapjes dhe shtrirjes së kriminalitetit siç janë:

- ⇒ **Veprat penale KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE**, që zënë rreth **49 për qind** ose krahasuar me vitin 2006 me **rritje 10 për qind**;
- ⇒ **Veprat penale KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT**, që zënë **27 për qind**, ose krahasuar me vitin 2006 me **rritje 21 për qind**, dhe;
- ⇒ **Veprat penale KUNDËR PERSONIT**, që zënë rreth **16 për qind** ose krahasuar me vitin 2006 me **ulje 5 për qind**;




Procedimet e regjistruara për grup vepra penale të tjera janë në përqindje më të ulët, si:

- ⇒ **veprat penale KUNDËR MJEDISIT** zënë rreth **2 për qind** dhe krahasuar me vitin 2006 kanë **ulje 19 për qind**,
- ⇒ **veprat penale KUNDËR DREJTËSISË** zënë rreth **1 për qind** dhe kanë **rritje 1 për qind**, ndërsa
- ⇒ **veprat penale USHTARAKE** zënë rreth **5 për qind** dhe krahasuar me vitin 2006 kanë **rritje 4 për qind**.

Tabela e mëposhme jep të dhëna për procedimet e regjistruara për grup veprat penale sipas krerëve të K. Penal, të krahasuara në vitet 2006-2007 dhe tendencat në ulje ose në rritje të tyre.

Veprat Penale sipas krereve K.Penal	Viti 2006	Viti 2007	Krahasimi
1.V.P K/Personit	2561	2427	Ulje 5 %
2.V.P K/Pasuris & Ekonomi	7010	7730	Rritje 10 %
3.V.P K/Mjedisit	296	239	Ulje 19 %
4.Krime K/Marrëdh. Shtetet Tjera	3	3	Shifra njejta
5.Akte Terroriste	6	3	Ulje 50 %
6.Krime K/Autoritetit të Shtetit	3447	4180	Rritje 21 %
7.V.P K/Drejtësisë	195	196	Rritje 1 %
8.V.P K/Zgjedhjeve	3	21	Rritje 7 herë
9.V.P Ushtrake	792	821	Rritje 4 %




Analiza e këtyre treguesve, sipas grup veprave ose veprave penale të veçanta, evidenton gjendjen, përhapjen dhe tendencat, si më poshtë:

I. Në ndjekjen penale të veprimtarisë së krimit të organizuar, kriminalitetit në fushën e narkotikëve, prostitucionit, trafikeve të paligjshme, të korrupsionit dhe veprave penale të lidhura me to evidentohet se janë ndjekur penalisht **1.808** procedime, me 1418 të pandehur ose krahasuar me vitin 2006 **me rritje 11 për qind të procedimeve dhe të pandehurve të ndjekur penalisht.** Është ngritur akuzë në gjykatë për 832 të pandehur dhe janë gjykuar e dënuar **599** persona ose krahasuar me vitin 2006 **me rritje 8 për qind** të pandehurve të dërguar në gjyq për këto vepra penale të rënda.

Në tabelën dhe paraqitjet grafike si më poshtë evidentohen treguesit dhe kurba e tyre për veprat penale prioritet i punës së prokurorisë shqiptare në vitin 2007 dhe krahasimi me vitin 2006.

P R I O R I T E T E T	2007				
	Proc/Ndj	Pand.Nd/Pen	Pand.D/Gjyq	Pand.Denuar	Pand.Gjyk
Krimi Organizuar	35	101	30	25	51
Trafik Q/Njerezore & Shfryt.Prostituc	449	375	246	227	149
Kultivim Trafikim L/Narkotik	691	557	384	285	220
V.Penale K/Korrupsionit e etj	663	385	172	62	142
Gjithsejt	1808	1418	832	599	562



Vitet	2006	2007	Krahasimi
Prioritetet	Proc/Ndj	Proc/Ndj	
Krimi Organizuar	27	35	Rritje 30%
Trafik Q/Njerezore & Shfryt.Prostituc	379	449	Rritje 18%
Kultivim Trafikim L/Narkotik	598	691	Rritje 16%
V.Penale K/Korrupsionit	629	633	Rritje 1%

Analiza e drejtimeve kryesore sipas llojit të krimeve që kanë qenë prioriteti i punës së prokurorisë, evidenton gjendjen dhe përhapjen, si më poshtë:



1 Goditja e grupeve kriminale ka qenë prioriteti i punës në luftën kundër krimit të organizuar dhe treguesit e efektivitetit të ndjekjes penale në luftën kundër tyre kanë progres të vazhdueshëm. Në vitin 2007, janë ndjekur penalisht **31 grupe kriminale, me 101 të pandehur**. Është ngritur akuzë në gjykatë ndaj 30 të pandehurve dhe janë gjykuar e dënuar 25 të pandehur anëtar të këtyre grupeve kriminale, si dhe vazhdon gjykimi për 51 të pandehur të mbartur në gjykim. **Janë në hetim 22 grupe kriminale me 69 të pandehur**. Për këto grupe kriminale vazhdojnë hetimet, në bashkërendim të ngushtë edhe me autoritetet gjyqësore të huaja.

2 Për veprat penale të trafikimit të paligjshëm të qenieve njerëzore, shfrytëzimit të prostitucionit dhe veprave penale të tjera të lidhura me to, janë ndjekur 379 procedime, me 449 të pandehur ose krahasuar me vitin 2006

me rritje 18 për qind të procedimeve dhe 14 për qind të pandehurve. Është ngritur akuzë në gjykatë për 246 të pandehur dhe janë gjykuar e dënuar 227 të pandehur ose krahasuar me vitin 2006 me **rritje 18 për qind** të pandehurve të dërguar në gjyq dhe me **rritje 4 për qind** të pesonave të gjykuar e dënuar për këto vepra penale të rënda.

Në tabelën dhe paraqitjet grafike më poshtë, për këto vepra penale, janë evidentuar treguesit për vitin 2007 të krahasuara me vitin 2006.

Trafikimi QNj & Shfrytëzimi Prostitucionit	Viti 2006	Viti 2007	Krahasimi
Neni 110/a	3	5	Rritje 67%
Neni 113	38	52	Rritje 37%
Neni 114	23	38	Rritje 65%
Neni 114/a	58	65	Rritje 12%
Neni 114/b	45	26	Ulje 42%
Neni 115	1	4	Rritje 4 here
Neni 128/b	11	9	Ulje 18%
Neni 298	200	250	Rritje 25%
Gjithsejt	379	449	Rritje 18%



Sipas llojeve të veprave penale shifrat evidentojnë se në vitin 2007 procedimet penale të ndjekura, janë:

- 5 procedime për trafikim të njerëzve;
- 9 procedime për trafikim fëmijësh;
- 116 procedime për trafikim të femrave për prostitucion dhe shfrytëzim prostitucioni në rrethana rënduese;
- 65 procedime për prostitucion, shfrytëzim të prostitucionit dhe mbajtje të lokaleve për prostitucion, si dhe;
- 250 procedime për dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit (kundrabanda e njerëzve).

Këto tregues krahasues evidentojnë faktin e **tendencës në ulje të trafikut të qënieve njerëzore**, por dhe **tendencën në rritje të fenomenit të prostitucionit dhe të shfrytëzimit të tij brenda vendit**.

Gjatë vitit 2007, në mënyrë të vacantë, Prokuroria për Krime të Rënda ka hetuar 36 procedime për llojet e ndryshme të trafikimit të qënieve njerëzore. Janë hetuar 10 procedime për krimin e trafikimit të të miturve (neni 128/b), 23 procedime për krimin e trafikimit të femrave për qëllime shfrytëzimi në tregun e prostitucionit (neni 114/b) dhe 3 procedime për krimin e trafikimit të njerëzve (neni 110/a) ndërkohë që për vitin 2008 janë regjistruar deri tani 12 procedime, prej të cilave 7 janë për veprën penale të “trafikimit të femrave” dhe 5 për veprën penale të “trafikimit të të miturve”. Në vëllimin e përgjithshëm të procedimeve të hetuara gjatë vitit që kaloi nga PKR, krimet e trafikimit të qënieve njerëzore kapin shifrën prej 16,2%. Hetimet e çështjeve të kësaj natyre vërehet se konsumojnë afat hetimesh më të gjatë në raport me çështjet e tjera (10,4 muaj hetime, kundrejt mesatares prej 9.2 muajsh). Ky rezultat shpjegohet me faktin se viktimat trafikohen dhe shfrytëzohen jashtë territorit të Republikës, ndaj administrimi i provave të fajësisë kërkon detyrimisht bashkëpunim ndërkombëtar me autoritetet e huaja gjyqësore. Pikërisht, vështirësia e hetimeve të tilla, zakonisht të filluara mbi kallëzimin e të dëmtuarave, kërkon verifikimin e çdo elementi që konfirmon vërtetësinë e thënieve të viktimës, vërtetimin e fakteve të ndodhura jashtë shtetit, ndaj është e shpjegueshme koha më e gjatë që duhet për të dokumentuar veprimtarinë kriminale. Gjatë vitit që kaloi janë shënuar arritje në bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar, sidomos me Italianë, Norvegjinë, Francën, etj.

Gjatë vitit 2007, për këtë kategori krimesh, përfunduan hetimet dhe u dërguan për gjykim 8 procedime, duke akuzuar 13 persona. Ndërkohë, përfundoi shqyrtimi gjyqësor dhe u dha dënim për 8 çështje që u përkasin 10 personave të akuzuar. Prokuroria është orientuar drejt ashpërsimit të politikës së dënimit për krimet e trafikimit të qënieve njerëzore, duke iu përgjigjur jo vetëm nevojave për parandalimin e përgjithshëm të kësaj forme moderne të skllavërimit të njerëzve, por edhe për të ndihmuar në arritjen e standarteve të kërkuara nga organizmat

europiane, tepër të ndjeshme për emergjencën e frenimit të këtij fenomeni. Dënimi mesatar i kërkuar nga Prokuroria ka qenë 14 vjet burgim, ndërkohë që gjykata ka dhënë vendime dënimi me burgim që kapin një mesatare rreth 12,7 vjet burgim.



Në analizë të faktorëve kriminogjenë që ndikojnë në lindjen dhe zhvillimin e dukurisë kriminale të trafikimit të njerëzve duhet të përmendim: të ardhurat e konsiderueshme që sigurohen nga trafikantët, pa qenë nevoja për të kryer investime fillestare të kapitaleve, vështirësitë e hetimeve për sigurimin e provave që ndodhen shumë larg vendit të origjinës, varfëria dhe injoranca që i joshin viktimat për të pranuar propozime për një jetë më të mirë, mundësia e lëvizjes së lirë dhe e spostimit të viktimave në Europë, në raport me kërkesat e tregut dhe në varësia nga reagimi i forcave të rendit publik ndaj fenomenit, etj.

Faktet e hetimeve vërtetojnë se viktimat zakonisht janë vajza të reja, shpeshherë të mitura (nën 18 vjeç), me origjinë nga familje me të ardhura të pamjaftueshme, me mungesa në shkollim dhe në formimin e përgjithshëm, në pamundësi që të mbështeten dhe të mbrohen nga familja apo rrethi shoqëror. Metoda më e zakonshme e rekrutimit të tyre vazhdojnë të jenë martesat e rreme, të shoqëruara me premtime për një jetë më dinjitoze në Evropë.

Në aspektin e goditjes së pasurisë së trafikantëve të vënë në rrugë të kundërligjshme, Prokuroria ka proceduar me sekuestime objektesh të rëndësishme, sipas ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”. Por, rezultatet pas vendimit të gjykatës kanë qenë përgjithësisht zhgënjyese, pasi për disa objekte të rëndësishme, nuk është pranuar sekuestrimi për t’iu hapur rrugë procedurave të sekuestrit dhe konfiskimit. Gjithashtu, mbrojtja e viktimave me padi civile në procesin penal mund të thuhet se ka dështuar. Edhe në disa raste të pakta kur viktimat janë legjitimuar në cilësinë e paditësit civil në procesin penal, padia civile është veçuar nga shqyrtimi së bashku me akuzën penale. Kjo është një procedurë e parashikuar nga ligji, por detyrimi i viktimës për të ndjekur edhe çështjen civile zgjat afatet e zgjidhjes përfundimtare dhe, përgjithësisht, i dekurajon viktimat në kërkimin e dëmshpërblimit.

3 Për veprat penale të trafikut të narkotikëve dhe kultivimit, prodhimit dhe shitjes së tyre, janë ndjekur penalisht 691 procedime, me 557 të pandehur ose krahasuar me vitin 2006 me rritje 16 për qind të procedimeve të ndjekura. Është ngritur akuzë në gjykatë për 384 të pandehur dhe janë gjykuar e dënuar 285 të pandehur përfshi dhe të pandehur të mbartur në gjykim. Krahasuar me vitin 2006 evidentohen tregues **në rritje 16 për qind të pesonave ndaj të cilëve është ngritur akuzë në gjykatë.** Në tabelën dhe paraqitjet grafike janë evidentuar treguesit për këto vepra penale dhe të krahasuara në vitet 2006-2007.

Kultivim, Prodhim, Trafikim Narkotikeve	Viti 2006	Viti 2007	Krahasimi
Neni 283	333	297	Ulje 11%
Neni 283/a	62	76	Rritje 23%
Neni 284	201	314	Rritje 56%
Neni 284/a	2	4	Rritje 200%
Gjithsejt	598	691	Rritje 16%



Procedimet penale të ndjekura sipas grupimit të këtyre veprave penale, janë:



- 611 procedime për kultivim, prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike, si dhe;
- 80 procedime për trafikim të lëndëve narkotike, nga individë dhe grupe kriminale.

Në vitin 2007, ka rritje të ndjeshme në goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve. Procedimet penale për prodhim dhe shitje të narkotikëve kanë **rritje në masën 11 për qind**. Ndërsa, lidhur me kultivimin e bimeve narkotike, gjatë vitit që kaloi, është rritur intensiteti i goditjes nga agjensit e zbatimit të ligjit në këtë fushë, për rrjedhojë procedimet penale të ndjekura për këtë veprë kanë **rritje 56 për qind** krahasuar me vitin 2006.

4. Për vepra penale në fushën e korrupsionit dhe që lidhen me veprimtarinë e kundraligjshme të punonjësit shtetëror ose në shërbimin publik, janë ndjekur penalisht 663 procedime, me 385 të pandehur ose krahasuar me vitin 2006 me **rritje 5 për qind të procedimeve dhe **27 për qind** të pandehurve të ndjekur. Për këto vepra penale janë dërguar për gjykim 172 të pandehur dhe janë gjykuar e dën timer 62 persona.**

Në tabelën dhe paraqitjet grafike janë evidentuar treguesit për këto vepra penale dhe të krahasuara në vitet 2006-2007.

V.Penale Korrupsion dhe të lidhura me detyrën	Viti 2006	Viti 2007	Krahasimi
Neni 164/a	1	1	Shifra njejt a
Neni 164/b	3	1	Ulje 77%
Neni 244	6	4	Ulje 33%
Neni 245	2	4	Rritje 2 herë
Neni 248	439	481	Rritje 10%
Neni 70 KPU	69	51	Ulje 36%
Neni 250	48	55	Rritje 15%
Neni 256	6	3	Ulje 50%
Neni 257	3	0	Ulje 3 herë
Neni 258	11	16	Rritje 45%
Neni 259	36	39	Rritje 8%
Neni 260	3	2	Ulje 33%
Neni319	3	1	Ulje 77%
Neni 319/a	2	2	Shifra njejt a
Neni 328	1	3	Rritje 3 herë
Gjithësej	629	663	Rritje 5%



4.1 Për vepra penale të korrupsionit janë ndjekur 57 procedime, me 50 të pandehur ose krahasuar me vitin 2006 me shifra pothuaj të njehta. Janë dërguar për gjykim 22 të pandehur, prej të cilëve janë gjykuar dhe dënuar 19 persona, si dhe ndodhen në gjykim 13 persona të tjerë. Sipas llojit të veprave, procedimet penale të ndjekura janë:

- 2 procedime për korrupsion aktiv dhe pasiv në sektorin privat, nenet 164/a e 164/b të K. Penal;
- 4 procedime, për korrupsion aktiv të personave që ushtrojnë funksione publik, neni 244 i K. Penal;
- 4 procedime, për korrupsion aktiv të funksionarëve të lartë shtetëror ose të zgjedhurve vendorë, neni 245 i K. Penal;

- 39 procedime, për korrupsion pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike, neni 259 i K. Penal;
- 1 procedime, për korrupsion pasiv të funksionarëve të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendorë, neni 260 i K. Penal;
- 3 procedime për korrupsion aktiv dhe pasiv të funksionarëve të drejtësisë, nenet 319 e 319/a; si dhe
- 3 procedime për dhënie të shpërblimeve dhe premtimeve në çënim të sistemit demokratik të zgjedhjeve, neni 328 të K. Penale;

4.2. Për vepra penale të shkeljes së barazisë në tendera dhe për shkelje të kontributeve të dhëna nga shteti, nenet 256, 257 e 258 të K. Penal, janë ndjekur penalisht 19 procedime, me 17 të pandehur ose krahasuar me vitin 2006 *me rritje 46 për qind të personave të ndjekur penalisht për këto krime.* Janë dërguar për **gjykim 10 të pandehur, të cilët janë në proces gjykimi.**

4.3. Për vepra penale të shpërdorimit të detyrës dhe veprime arbitrare, nenet 248 e 250 të K. Penal dhe 70 të K. P. Ushtarak, janë **ndjekur 587 procedime, me 318 të pandehur** ose krahasuar me vitin 2006 *me rritje 5.5për qind të procedimeve të ndjekura.* Janë dërguar për gjykim 140 të pandehur, prej të cilëve 45 janë gjykuar dhe dënuar, si dhe janë në proces gjykimi 42 persona të tjerë.

Personat e proceduar penalisht për këto vepra përfaqsojnë: 110 nëpunës civil të Administratës Publike qendrore dhe vendore, të niveleve: funksionarë 4 persona, drejtues të lartë 10 persona, të mesëm 29 persona, të ulët 10 persona, ekzekutiv 1 persona dhe nëpunës të thjeshtë 56 persona.

Faktorët që kanë ndikuar në rritjen e efektiviteti në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, trafikimit të qenieve njerëzore dhe narkotikëve, janë:


- Kryerja e hetimeve proaktive, në veçanti nga Prokuroria për Krime të Rënda dhe Njësia e Përbashkët Hetimore kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë në bashkëpunim me shërbimet e policisë gjyqësore të strukturave të specializuara në Policinë e Shtetit;
- Krijimi, në shtator 2007, i Njesisë së Përbashkët Hetimore kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë;
- Përdorimi me efektivitet i mjeteve të posaçme të hetimeve;
- Bashkëpunimi i prokurorëve me dëshmitarë dhe bashkëpunëtorë të drejtësisë, duke i përfshirë ata në programin e mbrojtjes së veçantë dhe duke iu garantuar mbrojtjen e tyre dhe të familjeve të tyre në zbatim të ligjit;
- Hetimi i pasurisë së autorëve të krimit të organizuar dhe sekuestrimi i pasurisë së tyre të rrjedhur nga krimi në zbatim të ligjit “Për parandalimin dhe


goditjen e krimit të organizuar”, duke i’u ndërprerë të ardhurat nga burime financiare kriminale dhe mundësinë e riciklimit të tyre;

- Përmirësimi i vazhdueshëm i bashkëpunimit në planin rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe;
- Bashkëpunimi i ngushtë me misionet ndërkombëtare që asistojnë policinë dhe prokurorinë shqiptare.

II.1 Për veprat penale kundër personit, janë regjistruar 2427 procedime, me 1413 të pandehur, prej të cilëve 494 të arrestuar në burg ose **me ulje 5 për qind** të procedimeve krahasuar me vitin 2006. Është ngritur akuzë në gjykatë për 1032 të pandehur, prej të cilëve janë gjykuar e dënuar 717 persona dhe pritët gjykimi i të pandehurve të tjerë, ku përfshihen dhe të pandehurit e mbartur në gjykim për këto vepra. Në tabelën dhe paraqitjet grafike janë evidentuar treguesit për këto vepra penale sipas seksioneve të këtij kreu të K. Penal, të krahasuara në vitet 2006-2007.

V.P K/Personit	Viti 2006	Viti 2007	Krahasimi
Krime K/Jetes dashje	877	828	Ulje 6 %
Krime K/Jetes pakujdesia	24	29	Rritje 21%
V.P K/Shend. Dashje	929	813	Ulje 12%
V.P K/Shend. Pakujdesia	17	10	Ulje 41%
Krime Seksuale	95	102	Rritje 7%
V.P K/Liris personit	111	98	Ulje 12%
V.P K/Moralit dinjitetit	143	156	Rritje 9%
V.P K/Femijve & Familjes	44	41	Ulje 7 %







Analiza e treguesve për këtë grup veprash penale evidenton se **krimet kundër jetës me dashje kanë ulje rreth 6 për qind, ku përfshihet tendenca në ulje**: - 4 për qind e vrasjeve me dashje, dhe - 32 për qind e vrasjeve të cilësuar. Gjithashtu, evidentohet **ulje** në masën: -12 për qind e krimeve kundër shëndetit të kryera me dashje, - 41 për qind e krimeve kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia, - 12 për qind e veprave kundër lirisë së personit dhe - 7 për qind e veprave kundër fëmijve dhe familjes. Por, evidentohet **rritje**: - 21 për qind e krimeve kundër jetës të kryera nga pakujdesia; - 7 për qind e krimeve seksuale dhe - 9 për qind e veprave penale kundër moralit dhe dinjitetit.

2. **Për veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike** janë regjistruar 7730 procedime, me 3290 të pandehur, prej të cilëve 1023 të arrestuar në burg. Është ngritur akuzë në gjykatë për 3064 të pandehur ose me **rritje 12 për qind** e të pandehurve, janë gjykuar dhe dënuar 2639 persona, si dhe pritët gjykimi për të pandehur të tjera. Në tabelën dhe paraqitjet grafike janë evidentuar treguesit për këto vepra penale sipas seksioneve të këtij kreu të K. Penal, të krahasuara në vitet 2006-2007.


V.P K/Pas.&Ekonomi	Viti 2006	Viti 2007	Krahasimi
Vjedhja e Pasurise	3828	4425	Rritje 16%
Mashtrimet	240	405	Rritje 69%
Shkatërrimi Prones	603	921	Rritje 53%
V.P ne Shoq/Tregtare	7	10	Rritje 43%
Krime Fush/Dogana	538	344	Ulje 26%
V.P Taksa & Tatime	86	101	Rritje 17%
Fallsif. Monell/LVlere	53	40	Ulje 25%
Fallsif.Dokumentave	1594	1413	Ulje 11%
V.P Fush.Falimetimit	0	0	0.00
V.P k/Lojrave Fatit	9	12	Rritje 33%
V.P K/Regj. Tokens	52	59	Rritje 13%



Analiza e treguesve sipas seksioneve të këtyre grup veprave ose veprave penale të veçanta, evidenton përhapjen më të madhe dhe tendencat, si më poshtë:

2.1 Për vjedhje të pasurisë, janë regjistruar 4425 procedime, me 1780 të pandehur, që zënë rreth 57 për qind të procedimeve për vepra penale kundër pronës dhe në sferen ekonomike, ose krahasuar me vitin 2006 me rritje 16 për qind të procedimeve. Në këtë grup veprash penale, për krime të rënda, si në paraqitjen grafike më poshtë, evidentohet **ulje:** - 32 për qind të procedimeve për vjedhje me dhunë, - 7 për qind e procedimeve për vjedhje me armë, si dhe rritje - 43 për qind e procedimeve për vjedhje me pasojë vdekje;

	Viti 2006	Viti 2007	Krahasimi
Vjedh. Pasurise	3828	4425	Rritje 16%
Vjedhja	3344	3645	Rritje 9%
Vjedhja me dhune	90	61	Ulje 32 %
Vjedhja me arme	58	54	Ulje 7%
Vjedhja pasoj vdekje	7	10	Rritje 43%



2.2 Për shkatërrim të pronës, publike e private, janë regjistruar 921 procedime, ose **me rritje rreth 53 për qind** të procedime, krahasuar me vitin 2006;


2.3 Për vepra penale në fushën e doganave janë **regjistruar 344 procedime** ose **me ulje 26 për qind të procedimeve**. Janë dërguar për gjykim 185 të pandehur, prej të cilëve 164 persona janë dënuar dhe pritët gjykimi për të pandehur të tjerë, përfshi dhe të pandehurit që janë mbartur në gjykim ose krahasuar me vitin 2006, shifrat janë pothuajse të njëjta lidhur me numrin e personave ndaj të cilëve është ngritur akuzë dhe që janë deklaruar fajtorë dhe dënuar nga gjykata.

2.4 Për vepra penale në fushën e tatimeve janë **regjistruar 101 procedime** ose **me rritje 17 për qind** të numrit të procedimeve krahasuar me vitin 2006. Janë dërguar për gjykim 60 të pandehur ose me **rritje 25 për qind** dhe janë gjykuar dhe dënuar 21 persona.

2.5 Për fallsifikim të dokumentave dhe letrave me vlerë, janë **regjistruar 1453 procedime**, që **zënë rreth 18 për qind** të procedimeve për veprat penale kundër pronës dhe në sferën ekonomike. Krahasuar me vitin 2006 **me ulje 12 për qind të procedimeve të regjistruara për këto vepra**. Janë dërguar për gjykim 801 të pandehur dhe janë gjykuar e dënuar 799 persona.

3. Për veprat penale kundër autoritetit të shtetit janë regjistruar 4180 procedime, me 2911 të pandehur, prej të cilëve 1024 persona me masë sigurimi “arrest në burg”. Është ngritur akuzë në gjykatë për 2439 të pandehur ose krahasuar me vitin 2006 me rritje rreth 10. 7 për qind dhe janë gjykuar e dënuar 1736 persona, si dhe pritët gjykimi për të pandehurit e tjerë, përfshi dhe të pandehurit që janë mbartur në gjykim. Në tabelën dhe paraqitjet grafike janë evidentuar treguesit për këto vepra penale sipas seksioneve të këtij kreu të K. Penal, të krahasuara në vitet 2006-2007.

	Viti 2006	Viti 2007	Krahasimi
Krime K/Aut.Shtetit	3447	4180	Rritje 21%
V.P K/VepShtet Shtetasit	522	630	Rritje 21%
V.P. K/VepShtet P/shtet	443	420	Ulje 5%
V.P K/Rend Sig.Pub.	2256	2839	Rritje 26%
Neni 278	475	487	Rritje 3%
Neni 290	631	850	Rritje 35%
V.P K/Sekretit Kuf.	256	291	Rritje 14%



Analiza e shifrave sipas seksioneve të këtyre grup veprave dhe/ose veprave penale më të përhapura, evidenton, si në tabelën dhe paraqitjen grafike më sipër, tendencën e veprave, si më poshtë:

3.1 Për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit, janë regjistruar 630 procedime, ose krahasuar me vitin 2006 me rritje 21 për qind të procedimeve;

3.2 Për vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike, janë regjistruar 2839 procedime, ose krahasuar me vitin 2006 me rritje 26 për qind të procedimeve. Në procedimet penale për këtë grup veprash, - 17 për qind e zë armëmbajtja pa leje, e cila ka rritje 3 për qind krahasuar me vitin 2006, si dhe

– 29.9 për qind e zë shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, e cila, gjithashtu, ka rritje 35 për qind të procedimeve.

V. PËRMBUSHJA E ANGAZHIMEVE DHE DETYRAVE TË TJERA INSTITUCIONALE, SI DHE FORCIMI I PARTNERITETIT ME AKTORËT E TJERË TË SISTEMIT TË DREJTËSISË PENALE.

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Më lejoni t’Ju bëj të ditur se në përmbushje të angazhimit institucional të prokurorisë në kuadrin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me BE-në, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm ka ndërmarrë iniciativa dhe aktivitete zbatuese, për kryerjen e reformave në prokurori, me synim rritjen e efektivitetit në ndjekjen penale, duke garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

1. Në kuadrin e reformës në sistemin e drejtësisë, **Prokuroria ka identifikuar nevojat për kryerjen e reformës në sistemin e prokurorisë, lidhur me përmirësimin e kuadrit ligjor, përmirësimet strukturore dhe forcimin e kapaciteve**, në përmbushje të synimeve për të rritur më tej efektivitetin dhe ligjshmërinë në procesin e ndjekjes penale, duke garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të individit në përputhje me standartet që parashikon Kushtetuta dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj.

2. Me synim kapërcimin e vështirësive në përballje me sfidat tashmë të evidentuara në punën tonë, **prokuroria ka përcaktuar drejtimet më të rëndësishme prioritare dhe objektivat, masat e aktivitetet konkrete për përmbushjen e përgjegjësisë së saj.**

2.1 “Përmirësimi dhe fuqizimi i kapaciteteve të Prokurorisë në ndjekjen penale, në hetim dhe në gjykim, si dhe në mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve penale”, përbën prioritet të rëndësishëm të punës sonë. Në përmbushje të këtij prioriteti, prokuroria ka përcaktuar disa objektiva, si dhe synon realizimin e masave dhe aktiviteteve, si më poshtë:

2.1.1. “Përzgjedhja për emërimin dhe ngritjen në detyrë të prokurorëve, me anë të vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale të tyre” përbën një objektiv të rëndësishëm, për realizimin e të cilit pritet realizimi i masave dhe aktiviteteve, në kuadrin e Projektit të Komisionit Europian, për binjakëzimin e Prokurorisë Shqiptare me Prokuroritë homologe italiane dhe spanjolle, me synim implementimin e suksesshëm të sistemit të vlerësimit të punës dhe të aftësive profesionale të prokurorëve.

2.1.2 “Përmirësimi i funksionimit të Inspektoriatit të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm”, përbën një objektiv tjetër për të garantuar një vlerësim transparent dhe mbi bazën e meritave për prokurorët, si dhe për të verifikuar dhe vlerësuar në vazhdimësi qëndrueshmërinë në detyrë të tyre. Në përmbushje të këtij objekti, gjithashtu, në fazën e zbatimit të projektit të binjakëzimit me prokuroritë homologe, shpresojmë të jemi të suksesshëm për forcimin e kapaciteteve të Inspektoriatit të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, me synim përmirësimin e punës së tyre në inspektimet dhe kontrollet periodike, si dhe për përgatitjen dhe vlerësimin e punës së prokurorëve.

2.1.3 “Rritja e transparencës në procesin penal”, gjithashtu, është një ndër objektivat prioritare të punës së Prokurorisë.

2.1.4 “Përmirësimi i menaxhimit të çështjeve në Prokurori”, është një ndër objektivat me të cilin synojmë ndihmën dhe kontrollin e vazhdueshëm të ecurisë së ndjekjes penale, për të ndikuar në rritjen e efektivitetit të ndjekjes penale dhe për të parandaluar e luftuar kundër fenomeneve korruptive brenda në prokurori. Në përmbushje të këtij objekti po punohet në kuadrin e një projekti me OPDAT-in.

3. Bashkërendimi i punës ndërmjet policisë gjyqësore dhe prokurorive mund të thuhet se ka progres, i cili ka ndikuar në forcimin e luftës kundër kriminalitetit. Siç përmenda më sipër, në vitin 2007 janë hetuar e gjykuar çështje të rëndësishme, me shumë të pandehur dhe për krime me pasoja të rënda dhe janë shënuar përparime në punën hetimore të përbashkët ndërmjet prokurorisë me policinë gjyqësore. Por, ka patur raste kur ky bashkëpunimi nuk ka funksionuar siç duhet. Jemi duke u përpjekur për t’u kuptuar më mirë nga partnerët (policia) se detyra e përbashkët e prokurorisë dhe policisë gjyqësore për hetimet paraprake nënkupton ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi të tyre, sipas funksioneve të caktuara me ligj. Marrëdhëniet e prokurorisë me policinë gjyqësore i konsiderojë shumë të rëndësishme për një luftë të sukseshme kundër kriminalitetit. Prokuroria është e ndërgjegjësuar për faktin se një klimë jo e mirë në këto marrëdhënie favorizon, inkurajon dhe nxit rritjen e kriminalitetit.

- **Në punën me policinë gjyqësore,** vazhdojmë të synojmë përmbushjen e standarteve nga policia që bashkëpunimi të përmirësohet në drejtimet kryesore, si më poshtë:
 - o Zbatimin efektiv nga policia të prioriteteve të politikës penale të udhëzuara nga prokurori;
 - o Angazhimin e saj për të kryer hetimet paraprake, si një ndër detyrat e rëndësishme funksionale të saj, duke rritur përgjegjshmërinë dhe profesionalizmin;

- o Trajnimin e saj për forcimin e kapaciteteve profesionale në zbatimin e ligjit penal dhe procedural penal, përdorimin me efektiv të mjeteve të veçanta të hetimit, si dhe;
- o Informimin në kohë dhe zbatimin në afat nga policia gjyqësore të urdhërimeve dhe/ose delegimeve të prokurorit.

3.1 Në këtë vështrim, për të përmirësuar organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të policisë gjyqësore në strukturat e Policisë së Shtetit, Ju bëj me dije se, **në prill 2008 u firmos Urdhëri i Përbashkët i Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm lidhur me organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, i cili ka hyrë në fuqi me 15 maj 2008.** Synimi ynë i përbashkët është për të riorganizuar shërbimet e policisë gjyqësore në përfaqësim me ligjin dhe sipas riorganizimit të strukturave të të gjitha niveleve në Policinë e Shtetit, për të përmirësuar funksionimin e shërbimeve të policisë gjyqësore në realizimin e misionit të tyre në luftë kundër kriminalitetit në përgjithësi dhe krimeve të rënda e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik e korrupsionit në veçanti.

4. Mbikëqyrja dhe vënia në lëvizje për ekzekutim të vendimeve gjyqësore penale të paekzekutura nga policia dhe përmbarimi për vitin 2007 ka progres. Përmirësimi i bashkërendimit nga **Spektori i Mbikëqyrjes së Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Vuajtjes së Dënimit në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm** me aktorët e tjerë si Policinë e Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, të cilët kanë rol të rëndësishëm në ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë, **ka ndikuar në progresin e arritur** për ekzekutimin e vendimeve penale të paekzekutuara.

5. Në përmbushje të Rekomandimeve të BE dhe të prioriteteve të qeverisë, në përballje me sfidën, luftën kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit, si dhe me synim për të rritur dhe forcuar bashkëpunimin ndërinstytucional dhe për të përmirësuar cilësinë dhe efektivitetin në hetimin e ndjekjen penale kundër kriminalitetit në këtë fushë, me asistencën dhe mbështetjen e OPDAT-it, në maj 2007, u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Financave dhe Drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit *“Për krijimin e njësisë së përbashkët hetimore, për hetimin e krimit ekonomik dhe korrupsionit”*. Në mbështetje të Kushtetutës dhe ligjit, si dhe në përmbushje të angazhimeve të këtij memorandumi, **u krijua Njësia e Përbashkët Hetimore për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit pranë Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë, si dhe Spektori Kundër Krimit Ekonomik dhe**

Korrupsionit në Drejtorinë e Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm. Në këto struktura janë përzgjedhur dhe caktuar prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore më profesionistë dhe më me përvojë në këtë fushë, si dhe më me integritet profesional dhe moral.

Në veprimtarinë e kësaj njësie të përbashkët hetimore **evidentohet fillim i mbarë i punës dhe progres në rritje në ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe korrupsionit**, nëpërmjet kryerjes së hetimeve proaktive dhe përdorimit me kujdes të mjeteve të posaçme të hetimit. Në këtë periudhë, **janë arrestuar dhe vazhdon ndjekja penale për korrupsion pasiv ndaj disa personave që ushtrojnë funksione publike**, të cilët akuzohen se gjatë kryerjes së detyrës/funksionit kanë kryer veprat penale të korrupsionit pasiv, shkelje të barazisë së pjesmarrësve në tendera, etj, nenet 258, 259 të K. Penal, etj.

6 Megjithë progresin e arritur, **Prokuroria mbetet e angazhuar për të rritur me tej efektivitetin në ndjekjen penale në luftë kundër krimit të organizuar dhe të çdo indicie që mund të ketë për veprime terroriste.** Siç theksova më sipër, ka hop cilesor në efektivitetin e ndjekjes penale për goditjen e grupeve kriminale të krimit të organizuar. Në këtë vështrim, me lejoni t'Ju bëj me dije se në bashkëpunim dhe me asistencën e ngushtë të misioneve ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri, Seksioni i Posacëm në Prokurorinë për Krime të Rënda, po operon për zbatimin me efektivitet të paketës ligjore që lidhet me sekuestrimin e aseteve të grupeve kriminale apo të dyshuarve që zhvillojnë aktivitet kriminal në fushat ku operon krimi i organizuar. Janë në ndjekje 23 procedime për hetim pasuror të sekuestruar dhe 6 procedime për hetim pasuror të konfiskuar, që përfshin pasuri të paluejtshme si: - biznese, lokale, hotele, komplekse magazinash, komplekse sportive, apartamente, truall, si dhe pasuri të luejtshme si: - autovetura, kartmonella në valut dhe në lek, etj.

Megjithë arritjet e deritanishme, evidentohen mangësi në administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Agjensia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ka mangësi në funksionimin normal të saj. Ka vonesa në ekzekutimin e sekuestrove të vendosura nga gjykata, raportet periodike për gjendjen e pasurive ose nuk hartohen ose hartohen me vonesë dhe perciptazi nga ana e saj, si dhe nuk merret me ekzekutimin e vendimeve të gjykatës në këtë fushë.

7. Prokuroria ka përmbushur të gjithë masat institucionale për përgjimet e telekomunikimeve. Krahas përmirësimit të kuadrit ligjor, po punohet për përmirësimin e akteve nënligjore, është krijuar struktura, infrastruktura dhe po punohet për forcimin e kapaciteteve. **Është evident**

progresi në përdorimin e mjeteve të veçanta të hetimit, përgjimet e telekomunikacionit, veprimet e simulara, etj, për goditjen e krimit të organizuar, korrupsionit, krimit ekonomik dhe krimeve të tjera të rënda. Ka përfunduar dhe së afërmi fillon funksionimi i një qendre të re për të realizuar përgjimet procedurale penale, e cila është vendosur pranë Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, me synim për të veçuar pjesën e përgjimeve procedurale penale nga Qendra Kombëtare e Përgjimeve në SHISH, ku do të kryhen vetëm përgjimet parandaluese në zbatim të ligjit.

8. Krahës prioritetit për rritjen e efektivitetit të ndjekjes penale, *përmirësimi i respektimit të të drejtave të njeriut në të gjitha fazat e ndjekjes penale, përbën një prioritet kryesor të punës sonë.* Në përmbushje të këtij prioriteti, prokuroria po mbikqyr respektimin e parimeve të sanksionuara në Kushtetutë dhe në ligj, të akteve ndërkombëtare “*Për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut*”, me synim për të mbrojtur dhe garantuar të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të personit të arrestuar, ndaluar, të paraburgosur apo të dënuar.

9. Gjatë vitit 2007, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, me mbështetjen e EURALIS-t, PAMECE-s, OPDAT-it, OSCE-së, Këshillit të Europës dhe KE-së ka organizuar disa kurse trajnimi për prokurorët e të gjithë niveleve, duke synuar forcimin e kapaciteteve të tyre në ushtrimin e funksioneve të përcaktuara në ligj.

10. “*Përmirësimi i Kapaciteteve të Administratës së Prokurorisë*”, mbetet një objektivi i prokurorisë për të ardhmen afatmesme, me synim përmirësim e cilësisë së punës në sektorët e administratës dhe ndërgjegjësim e tyre për rolin e rëndësishëm që punonjësit e administratës kanë në suksesin e reformave në prokurori. Në përmbushje të këtij objektivi Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm ka aplikuar për t’u përfshirë në projektet e Programin CARDS 2006 dhe jemi në pritje të një përgjigje.

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

11. Pavarësia e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve duhet të forcohet. Prokurorët duhet të kenë kapacitetin dhe mjetet e nevojshme për të ushtruar funksionet e ngarkuara me ligj. Për të realizuar këtë prioritet synojmë dhe kërkojmë mbështetjen Tuaj, në drejtimet si më poshtë:

11.1 Të akordohet buxhet i mjaftueshëm, për funksionimit normal të strukturave të prokurorive të të gjithë niveleve, për të përmbushur detyrimet që burojnë nga kushtetuta dhe ligji, si dhe për të intensifikuar marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, në hetimet e përbashkëta, në luftë kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe korrupsionit. Nuk mund të pretendohet për të rritur efektivitetin e ndjekjes penale dhe për të patur një Prokurori të fortë me një buxhet të dobët dhe të pamjaftueshëm, si dhe nuk mund të ketë institucion të pavarur pa i siguruar dhe garantuar një buxhet të pavarur.

11.2 Prokurorëve tu garantohet mbrojtje e veçantë sipas ligjit, në përmbushjen e funksioneve të tyre, veçanarisht për prokurorët për krime të rënda. Ka mbi pesë vjet që ligji parashikon mbrojtje të veçantë për prokurorët dhe gjyqtarët, ende nuk janë miratuar aktet nënligjore nga Këshilli i Ministrave në zbatim të tij, **(neni 35 i ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në R.Sh.”,** i ndryshuar dhe **neni 10 i ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krime të Rënda”)** për sigurimin dhe ruajtjen e posaçme të mjediseve të punës, ruajtjen e afërt fizike, mbrojtjen e familjes së tyre, etj. Kërkojmë mbështetjen Tuaj, për marrjen e masave të duhura që parashikon ligji, për mbrojtjen e prokurorëve dhe familjeve e banesave të tyre.

12. Sistemi i drejtësisë penale luan një rol kyç në mbikëqyrjen e shtetit të së drejtës. Vlerësoj imperative nevojën për forcimin e bashkërendimit të të gjithë aktorëve të sistemit të drejtësisë penale, duke siguruar dhe mbështetjen Tuaj, për të rritur më tej efikasitetin e këtij sistemi kundër fenomeneve kriminale, tradicionale, siç janë vrasjet për hakmarrje e gjakmarrje, etj, si dhe kundër korrupsionit, krimi të organizuar dhe ekonomik, që përbëjnë sfidën tonë kryesore. Krahës forcimit të bashkërendimit ndër-institucional, situata aktuale kërkon edhe hartimin e strategjive të një politike procedimi dhe dënimi më të studjuar dhe më të unifikuar, si në nivel rrethi gjyqësor, në nivel apeli dhe në shkallë vendi, duke garantuar respektimin e parimeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Të nderuar deputetë,

Sa më sipër, Ju bëra të ditur treguesit më kryesorë të ndjekjes penale, ngritjes së akuzës në gjykatë dhe të ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe treguesit e gjendjes, përhapjes dhe tendencat e kriminalitetit, në vitin 2007. Gjithashtu, parashtrova disa aspekte të tjera të veprimtarisë ligjore të prokurorisë si organ i pavarur kushtetues, si dhe disa prioritete dhe ide për përmirësimin e punës për vitin 2008, me synim për të orjentuar sadopak punën Tuaj në reformimin e sistemit të drejtësisë penale. Ju siguroj se Prokuroria, në të gjitha shkallët e saj, do të realizojë prioritetet në luftën kundër kriminalitetit në përgjithësi dhe atij të organizuar dhe korrupsionit në veçanti, duke rritur efektivitetin në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit, si dhe duke garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Ju faleminderit!

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

INA RAMA